



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
KESHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 3588/3 prot

Gramsh më 25/09/2023

V E N D I M

Nr. 65 dt. 23/09/2023

PER

**“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM  
2024-2026 PER BASHKINË GRAMSH TË RISHIKUAR”**

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 23.09.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, neni 41 pika 1, neni 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar; neni 36 të ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, Udhëzim plotësues nr. 06 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026” me shtojcat plotësuese, si dhe materialin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Gramsh ;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë projektin e Programit Buxhetor Afatmesem për vitet 2024 - 2026, të Bashkisë Gramsh të rishikuar, sipas relacionit shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (Shtojca 2, Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026) bashkelidhur dhe formateve të FPT bashkelidhur si me poshte :

*Tabela 1. Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë GRAMSH*

*Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit*

*Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike*

*Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike*

*Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike*

*Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit*

*Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit*

*Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit*

*Tabela 9. Të dhënat e Programit*

2-Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetar i Bashkise dhe aparati i Bashkise.

3-Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sekretari i Keshillit  
Xhulia GJINI



Kryetari i Keshillit te Bashkise  
Enis Zani

